

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 15<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23) në pajtim me nenin 67 paragrafi (1), (7) dhe (8) nga Ligji i njëjtë, dhe në lidhje me pikën 5 paragrafi (2) dhe pikën 10 të Udhëzimit për mbikëqyrjen e zbatimit të konceptit programor, ark. nr.01-2265/1 datë 3.5.2018, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vendosur për Kërkesës e pajtueshmërisë për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga lejet për transmetim në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë ark.nr.03-2948/1, datë 27.7.2023, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-3115/3 datë 15.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 26-të mbajtur më 14.8. 2023, miratoi sa vijon:

## VENDIM

1. JIPET pëlqim për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të Konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1 nr. 08-234, datë 30.4.2019, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, në pjesën që i referohet gjuhës së transmetimit, domethënë ku përveç transmetimit programor në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase, transmetuesi duhet të transmetojë program dhe në gjuhën turke.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë .

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) JON-RADIO SHPK Strugë (me emërtim të mëparshëm-JON-RADIO SHPKNJP Strugë) është posedues i lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-234 datë 30.4.2019, me kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh, e cili skadon më 2.4.2028 për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel shtetëror, në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), shërbim program muzikor në radio me format të specializuar ku lloji dominues i programit ka funksion argëtues, në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Gjuha e transmetimit të programit të transmetuesit është e specifikuar edhe në Konceptin programor, i cili është pjesë përbërëse e Lejes për Transmetim në Radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë (PA1 nr. 08-234 datë 30.4.2019) si Shoqcë nr. 3. Elementet e konceptit programor janë përcaktuar paraprakisht në Vendim për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr.08-527, datë 23.11.2018, me ndryshim të datës 25.1.2019, sipas të cilit në këtë konkurs publik SHTR JON-RADIO SHPK Strugë ka marrë lejen e transmetim në radio. Në vendimin e cituar për shpalljen e konkursit publik me ndryshimin e tij thuhet se formatin duhet të jetë radio folës-muzikor me format të specializuar ku lloji dominues i programit ka funksion argëtues dhe do të duhet të transmeton program në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Në konkursin publik të shpallur ndaj tij parapriu Studimi për përcaktim të arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio në nivel shtetëror (Nr ynë.ark..03-4951/1 datë 12.11.2018), ku në konkluzionet dhe rekomandimet, ndër të tjera ishte deklaruar se nuk ka radio kombëtare e cila transmeton program ose pjesë nga programi i komuniteteve etnike, para së gjithash në gjuhën shqipe.

Në pajtim me nenin 67 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), formati i shërbimit programor i transmetuesit ( i përgjithshëm ose i specializuar ) dhe udhëzimet thelbësore për punën e transmetuesit përcaktohen me konceptin programor. Transmetuesi është i detyruar të zbatojë së paku 80% të konceptit programor për të cilën i është dhënë leja brenda një jave. Për ndryshim ose plotësimin e konceptit programor për të cilën transmetuesi ka marrë leje për transmetim televiziv dhe radio, për më shumë se 20%, transmetuesi duhet të marrë pëlqim paraprak nga Agjencia. Kërkesa për miratim dorëzohet duke plotësuar formularin e përgatitur nga Agjencia dhe të publikuar në ueb faqen e saj. Koncepti programor në bazë të të cilën transmetuesi ka marrë lejen për transmetim televiziv ose radio, si dhe ndryshimet ose plotësimet publikohen në ueb faqen e Agjencisë (neni 67 paragrafët (6), (7) dhe (8) të LSHMAAV) .

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 23-të mbajtur më 19.7.2023, miratoi formularët e kërkesës së pëlqimit për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes, për transmetim televiziv dhe radio, dhe i publikoi në ueb faqen e Agjencisë.

Më datë 27.7.2023 SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, në pajtim me nenin 67 paragrafi (6) të LSHMAAV, ka paraqitur kërkesë të pëlqimit për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, ark.03-2948/1 datë 27.7.2023 në formular të përshtatshëm.

<sup>1</sup>Paragrafët (8) dhe (9) fshihen , shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

Transmetuesi kërkon ndryshim ose plotësim të konceptit programor në pjesën që i referohet gjuhës së transmetimit, domethënë përveç transmetimit të programit në gjuhën shqipe dhe maqedonase, të transmeton program edhe në gjuhën turke. Në kërkesën në fjalë transmetuesi ka sqaruar se : *pas analizës së kyer në treg në RMV, është paraqitur hapësirë për këtë kërkesë për vendosje në transmetim të emisioneve në radio në gjuhën turke, me kërkesë*". Sipas Udhëzimit për zbatim të mbikëqyrjes së konceptit programor ( ark. nr. 01-2265/1 datë 3.5.2018), koncepti programor përbëhet nga disa elementë që lidhen me programin e transmetimit, dhe njëri prej tyre ka të bëjë me gjuhën e transmetimit. Në kapitullin III " Vlerësimi i kriterëve për mbikëqyrjen " në këtë Udhëzues është konstatuar se gjuha e transmetimit është vlerësuar me 25 pikë dmth me 25%, e cila do të thotë se ndryshimi i kërkuar i konceptit programor nga ana e SHTR JON-RADIO SHPK Strugë arrin në më shumë prej 20% dhe për këtë është e nevojshme pëlqimi paraprak nga Agjencia. Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, sektori kompetent ka konstatuar se kërkesa është e plotë dhe e rregullt, si dhe se kërkesa për ndryshim nuk i shkel kushtet për marrje të lejes, PA1 nr.08-234, datë 30.4.2019 përcaktuar në Vendimin për shpalljen e konkursi publik PA1 nr.08-527, datë 23.11.2018, me ndryshimin e datës 25.1.2019, por është në kontekst dhe me konkluzionet e Studimit për përcaktimin e arsyesimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio në nivel shtetëror (Nr ynë,ark.03-4951/1 datë 12.11.2018), në të cilën ishte theksuar se nuk ka radio kombëtare që transmeton program ose pjesë të programit në gjuhën e bashkësive etnike, para së gjithash në gjuhën shqipe. Me shtimin e gjuhës turke, përveç gjuhës shqipe dhe maqedonase, do të pasurohet pluralizmi dhe do të mundësohet transmetim i program dhe në gjuhë tjetër të komuniteti etnik që jeton në RMV, dhe nuk do të suspensohet kushti që programi të transmetohet në gjuhën shqipe dhe maqedonase me përfaqësim më të madh të përmbajtjeve në gjuhën shqipe.

Duke marrë parasysh nga sa më lartë dhe duke pasur parasysh se Kërkesa e pëlqimit për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, ark.03-2948/1 datë 27.7.2023 është në pajtim me nenin 67 paragrafi (6) dhe (7) të LSHMAAV, Dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë i dorëzoi Këshillit të Agjencisë Propozim PA1 ark. nr. 03-2948/2, datë 10.8.2023, për marrje të vendimit për dhënie miratim për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1, nr. 08-234 datë 30.4.2019 të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, në rubrikën që i referohet gjuhës së transmetimit, domethënë përveç transmetim të programit në gjuhën shqipe dhe maqedonase, transmetuesi duhet të transmetojë edhe program në gjuhën turke.

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 67 paragrafi (1), (7) dhe (8) nga Ligji i njëjtë, dhe në lidhje me pikën 5 nënparagrafi 2 dhe pikën 10 të Udhëzimit për zbatimin e mbikëqyrjes së konceptit programor, ark.nr.01-2265/1 datë 3.5.2018, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, duke marrë vendim për kërkesën e pëlqimit për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë ark.nr.03-2948/1 datë 27.7.2023, sipas Konkluzionit ark.nr. 02-3115/3 datë 15.8.2023 Këshilli i Agjencisë ka marrë vendim si në dispozitiv. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

**Nr.03-2948/3**

**15.8. 2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike** : Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, të ngrejë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.